

Fatmir MEDIU



Datëlindja:21.01.1967

Vendlindja:Durrës

Email:Fatmir.Mediu@parlament.al

Jetëshkrimi:

Ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Gjeologji-Miniera, Dega e Inxhinierisë së Nxjerrjes së Naftës (1985-1990). Në vitet 1990-1991 ka punuar si Inxhinier në Ndërmarrjen e Nxjerrjes së Naftës, Patos.

Gjatë viteve 1991-1992 ka qenë kryetar i Partisë Republikane, dega Fier; 1992-1997: Zv.kryetar i Partisë Republikane Shqiptare; 1997 në vazhdim: Kryetar i Partisë Republikane Shqiptare. Z. Mediu ka qenë gjithashtu Ministër i Mbrojtjes (2005-2008), Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (2009-2013).

Gjatë karrierës së tij Z. Mediu ka marrë pjesë në konferenca, simpoziume, aktivitete, seminare e trajnime të shumta në fushën e diplomacisë, sigurisë, mbrojtjes, marrëdhënieve ndërkombëtare, parlamentarizmit etj. Ka qenë Deputet në pesë Legjislatura dhe aktualisht është Deputet i Kuvendit të Shqipërisë në Legjislaturën e IX si dhe anëtar i Komisionit të Ligjeve.